



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. devin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	778
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	31-07-2026
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues / Upravni Odbor/ Steering Committee

Nr. 01/778/2026

Datë: 30/07/2026

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe nenin 6, paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/L0197 për Zyrtarët Publik më datë 30 Korrik 2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja Nr. 16/2026 për Përdorimin e Telefonisë Fikse dhe Mobile në Akademinë e Drejtësisë.
- II. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv të AD-së;
- Drejtoreshës së DSHLP-së;
- Burimeve Njerëzore të AD-së;
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë.

Fejzullah Rexhepi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, si dhe nenit 6, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 korrik 2026, miraton:

RREGULLORE Nr. 16/2026
PËR PËRDORIMIN E TELEFONISË FIKSE DHE MOBILE
NË AKADEMINË E DREJTËSISË

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave për përdorimin e telefonisë fikse dhe mobile në Akademinë e Drejtësisë, duke përfshirë edhe përcaktimin e shumës së lejuar të shpenzimeve për përdorimin e telefonisë fikse dhe mobile, me qëllim të kryerjes efektive të punëve dhe detyrave zyrtare në kuadër të përgjegjësisë të zyrtarëve të Akademisë.

Neni 2
E drejta për telefonin postpaid

Të drejtë për përdorim të telefonit postpaid ka Drejtori Ekzekutiv i Akademisë, në vlerë deri në 50 € në muaj.

Neni 3
E drejta për mbushje të telefonit mobil

1. Të drejtë për mbushje mujore të telefonit mobil në Akademi kanë:

1.1. Drejtori Ekzekutiv – 50 € në muaj

1.2. Drejtori i Departamentit – 20 € në muaj

1.3. Udhëheqësi i Divizionit – 20 € në muaj

1.4. Zyrtarët e Akademisë – 10 € në muaj.

Neni 4
E drejta për telefonin fiks

1. Të drejtë për qasje në telefon fiks kanë zyrtarët e përcaktuar në nenet 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, si dhe çdo zyrtar tjetër i Akademisë, si vijon:

- 1.1. Drejtori Ekzekutiv – 30 € në muaj;
- 1.2. Drejtori i Departamentit – 20 € në muaj;
- 1.3. Udhëheqësi i Divizionit – 15 € në muaj;
- 1.4. Të gjithë zyrtarët e tjerë – deri në 10 € në muaj.

Neni 5
E drejta për pajisje me SIM kartele

Të drejtë për pajisje me SIM kartele ka Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Neni 6
Procedura e pajisjes me telefona

Çdo zyrtar i Akademisë, për t'u pajisur me telefon fiks, duhet fillimisht të paraqesë kërkesë për pajisje me telefon, e cila aprovet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Neni 7
Instalimi dhe mirëmbajtja

- 1. Përgjegjësia për instalimin dhe konfigurimin fillestar të rrjetit telefonik fiks në Akademinë e Drejtësisë i takon Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit (ASHI).
- 2. Divizioni për Teknologji Informative i Akademisë është përgjegjës për mirëmbajtjen, monitorimin dhe funksionimin e rregullt të rrjetit telefonik fiks, pas instalimit nga ASHI.
- 3. Në rast të ndonjë defekti në rrjetin telefonik fiks, zyrtari përgjegjës i Divizionit për Teknologji Informative është i obliguar të ndërmarrë masat e nevojshme për eliminimin e defektit dhe për rikthimin e funksionalitetit të rrjetit.

Neni 8
Shpenzimet shtesë për nga natyra dhe lloji i punës

- 1. Për shpenzimet që, për nga natyra dhe lloji i punës, tejkalojnë shumën mujore të përcaktuar me këtë rregullore, kërkohet miratimi paraprak i Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë.

2. Kërkesa për miratim për tejkalim të shpenzimeve të telefonisë fikse duhet të përcillet me arsyetim që dëshmon lidhshmërinë e pozitës së punës me nevojën për këto shpenzime.

Neni 9

Përgjegjësia për shfrytëzimin e telefonit

1. Telefoni zyrtar i Akademisë përdoret vetëm për kryerjen e detyrave zyrtare dhe përdoruesi i tij është i detyruar të shfrytëzojë me përgjegjësi.
2. Telefoni zyrtar nuk mund të përdoret për biseda private.
3. Të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumën e përcaktuar me këtë rregullore do të mbulohen nga zyrtari që ka tejkaluar shumën e lejuar.
4. Përdoruesit e telefonisë fikse, gjatë bisedave brenda Akademisë dhe me institucionet tjera publike në Kosovë, janë të obliguar të përdorin numrat centrex.

Neni 10

Akumulimi i shpenzimeve të telefonit

Shpenzimet e telefonisë nuk mund të akumulohen. Vlera e shpenzimeve mujore mbyllet në ditën e fundit të çdo muaji.

Neni 11

Planifikimi i shpenzimeve të telefonit

Akademia e Drejtësisë duhet t'i planifikojë dhe aprovojë shpenzimet e telefonisë në buxhetin vjetor fiskal të organizatës buxhetore.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Fejzullah Rexhepi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

